

Lushnje me 17. 03. 2021

**SHOQËRIA E BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR
“AJAS 88”**

STATUTI

KAPITULLI I

EMRI, FORMA, SELIA DHE KOHËZGJATJA

1. EMRI I SHOQËRISË

- 1.1.** Emri i Shoqërisë është “AJAS 88” (“Shoqëria”), i cili paraprihet në mënyrë të pandashme nga fjalët “Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor”, të cilat përfaqësojnë formën ligjore të saj.
- 1.2.** Anëtarët e Shoqërisë (“Anëtarët”) janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë deri në vlerën e kontributeve të nënshkruara të kapitalit të shoqërisë të përfaqësuar në kuota (“Kuota”).
- 1.3.** Në të gjitha shkresat, publikimet dhe dokumentat e shoqërisë, emërtimi i saj paraprihet nga fjalët “Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor”, pas të cilave shënohet emërtimi i shoqërisë dhe numri i regjistrimit të saj. Gjithashtu, në dokumentat, faturat, reklamimet dhe botimet e Shoqërisë, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, shënohen edhe:
- 1.3.1.** adresa e regjistruar, dhe
 - 1.3.2.** pasqyrimin e faktit që shoqëria është në procedura likuidimi, në qoftë se ky rast paraqitet.
- 1.4.** Në asnjë rast një shoqëri tjeter nuk mund të përdorë emërtimin e përcakuar në nenin 1.1 të këtij statuti.

2. FORMA LIGJORE

- 2.1.** Shoqëria është një subjekt i së drejtës shqiptare dhe ka formën ligjore të një shoqërie bashkëpunimi bujqësor, në përputhje me ligjin nr. 38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”.

3. SELIA

- 3.1.** Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: pasuria nr.1006/13-ND, Kodi Postar 9022, Rruga “Fitorja”, Mize, Divjake.
- 3.2.** Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjeter të Shqipërisë.
- 3.3.** Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. KOHËZGJATJA

4.1. Shoqëria ushtron veprimtarinë për një kohëzgjatje të pacaktuar.

KAPITULLI II

OBJEKTI

5. OBJEKTI I SHOQËRISË

5.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e veprimtarive si më poshtë:

5.1.1. Prodhimin, perpunimin, grumbullimin, ruajtjen, transportimin, marketingun dhe tregtimin e produkteve bujqesore ne gjendjen e tyre natyrale dhe te perpunuar.

5.1.2. Eksportimin e produkteve bujqesore jashte vendit.

5.1.3. Lidhja e marrëveshjeve me shoqëri analoge në vend dhe jashtë vendit.

5.1.4. Organizimi i veprimtarive edukuese dhe trajnimeve të specializuara të cilat janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e shoqërisë.

5.2. Në përputhje me legjisacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendor, Shoqëria ka të drejtë:

5.2.1. të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, finansiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë;

5.2.2. të kryejë çdo veprim në përbushje të interesave dhe nevojave të anëtarëve të saj sipas dispozitave të statutit dhe legjisacionit shqiptar në fuqi.

5.3. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.

5.4. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës.

5.5. Shoqëria kryen veprimtari dhe shërbime në kuadër të objektit të përcaktuar më sipër, përveç se me anëtarët e saj edhe me persona fizik ose juridik, të tretë, jo anëtarë, deri në 40 për qind të totalit të të ardhurave nga veprimtaritë e saj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor".

6. NDRYSHIME

- 6.1.** Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimitarisë së saj në çdo kohë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.


KAPITULLI III

ANËTARËT

7. KUSHTET PËR TË QENË ANËTAR

- 7.1.** Anëtarë të shoqërisë janë personat fizik dhe juridik të cilët përbushin nevojat dhe interesat e tyre lidhur me veprimitarinë që ushtrojnë në fushën e prodhimit te produkteve bujqesore, nëpërmjet shërbimeve, mallrave dhe produkteve të ofruara nga Shoqëria.
- 7.2.** Me qëllim përbushjen e objektit të shoqërisë, anëtarët janë të detyruar të marrin pjesë dhe të përbushin politikat ekonomike dhe sociale të Shoqërisë.
- 7.3.** Numri i anëtarëve është i pakufizuar, por në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 7.
- 7.4.** Kanë të drejtë të janë anëtarë:
- 7.4.1.** personat fizik dhe juridik.
- 7.5.** Çdo anëtar duhet të jetë madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. Personat juridik anëtar duhet të kenë fituar personalitetin juridik dhe ndaj tyre nuk duhet të ketë filluar asnjë procedurë likuidimi apo falimentimi.
- 7.6.** Nuk mund të janë anëtarë personat fizik ose juridik që kryejnë veprimitari konkuruuese me veprimitarinë e shoqërisë, përvçse kur kjo veprimitari zhvillohet në kuadër të cilësisë së tij si anëtar i shoqërisë. Gjithashtu, nuk mund të janë anëtarë personat fizik ose juridik që bashkëpunojnë me ata që zhvillojnë veprimitari konkuruuese në të njëjtin sektor me shoqërinë, përveç rasteve kur asambleja e përgjithshme vendos që është në interesin më të lartë të shoqërisë që ata të janë anëtarë.

8. PRANIMI I ANËTARËVE TË RINJ

- 8.1.** Kërkesa për pranimin e anëtarit të ri në Shoqëri bëhet me shkrim, i drejtohet administratorit dhe përmban të dhënat e mëposhtme:
- 


- 8.1.1.** emër, mbiemër, data dhe vendi i lindjes, adresa si dhe të dhënrat e kartës së identitetit;
- 8.1.2.** veprimtaria që kryen;
- 8.1.3.** deklaratën e përmbushjes së kritereve për të qenë anëtar sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Kandidati për anëtar, me anë të nënshkrimit të kërkesës për pranimin si anëtar, deklaroj se përmbush kriteret për të qenë anëtar i Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor “AJAS 88” dhe pranoj që të zbatoj aktin e themelimit, statutin dhe vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë si dhe të zbatoj standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga anëtarësia në shoqëri. Kandidati për anëtar, gjithashtu deklaron që në dijeninë e tij nuk ekziston asnjë shkak që kufizon anëtarësinë e tij në shoqëri”;

- 8.2.** Në rastin e personave juridik, përveç të dhënave të parashikuara më sipër, kërkesa duhet:
 - 8.2.1.** të jetë nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i personit juridik;
 - 8.2.2.** të përmbajë të dhëna mbi emërtimin e personit juridik, datën e regjistrimit, selinë dhe objektin e veprimtarisë;
 - 8.2.3.** të shoqérohet me vendimin e organit përkatës që ka të drejtë të kërkojë pranimin si anëtar. Vendimi duhet të përmbajë edhe deklaratën e përmbushjes së kritereve për të qenë anëtar, sipas formulimit të mësipërm, si dhe sasinë e kuotave që do të nënshkruhen.
- 8.3.** Çdo kandidat për anëtar, qoftë person fizik apo juridik, së bashku me kërkesën për pranimin si anëtar, duhet të parapaguajë edhe vlerën e kuotave që do të nënshkruajë.
- 8.4.** Administratori, pasi verifikon përmbushjen e kritereve të përcaktuara në ligjin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe këtë statut, ia kalon kërkesën asamblesë së përgjithshme e cila vendos në mbledhjen e saj më të parë. Në rast se administratori çmon se kërkesa nuk i përmbush kriteret e përcaktuara si më sipër, ia kthen atë kërkuesit me udhëzimet përkatëse për përmbushjen e kritereve. Kandidati për anëtar mund të ankohet ndaj vendimit të administratorit në mbledhjen më të parë të asamblesë së përgjithshme.
- 8.5.** Anëtari i ri konsiderohet i pranuar nga momenti kur merr njoftimin për vendimin e Asamblesë së Përgjithshme që miraton pranimin e tij. Pas marrjes së vendimit të pranimit nga Asambleja e Përgjithshme dhe pas njoftimit të anëtarit të ri, Administratori kryen regjistrimet përkatëse në regjistrin e anëtarëve që mban shoqëria si dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

- 8.6.** Në rast se Asambleja e Përgjithshme vundos të refuzojë kërkesën për pranimin e anëtarit të ri, Administratori i kthen menjëherë kërkuesit shumën e parapaguar përvlerën e kuotave sipas nenit 8.3.
- 8.7.** Shoqëria mban në selinë e saj një regjistër të anëtarëve, i cili është publik dhe i konsultueshëm dhe që përmban të gjitha të dhënat identifikuase të anëtarëve, adresat, si dhe kapitalin e nënshkruar e të shlyer prej tyre.


9. TË DREJTAT E ANËTARËVE

- 9.1.** Anëtarët kanë të drejta dhe përgjegjësitë e mëposhtme:
- 9.1.1.** të propozojnë ndryshimin e administratorëve të shoqërisë;
 - 9.1.2.** të propozojnë ndryshime apo përmirësimë të statutit;
 - 9.1.3.** të zgjidhen dhe të zgjedhin organet drejtuese, si dhe të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimeve të shoqërisë;
 - 9.1.4.** të kërkojnë dhe disponojnë kopje të statutit, të rregullores së brendshme apo të vendimeve të organeve drejtuese të shoqërisë;
 - 9.1.5.** të kërkojnë dhe të marrin të dhëna për gjendjen financiare dhe ekonomike të tyre brenda shoqërisë;
 - 9.1.6.** të informohen, sa herë që depozitojnë kërkesë me shkrim, lidhur me gjendjen financiare të shoqërisë, kryesisht, për:
 - 9.1.6.1.** llogaritë vjetore financiare;
 - 9.1.6.2.** raportin e veprimtarisë së shoqërisë;
 - 9.1.6.3.** mënyrën dhe procedurat e ndarjes së fitimit;
 - 9.1.6.4.** raportet e ekspertëve kontabël;
 - 9.1.7.** të informohen rregullisht për mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, duke përfshirë në informacion pikat e rendit të ditës, dokumentacionin e përgatitur për mbledhje, si dhe të dhëna të tjera, të cilat lidhen me vendimmarrjen për çështje të caktura, të cilat mund të prekin interesat e tyre.
- 9.2.** Administratori është i detyruar të informojë me shkrim anëtarin për çështjet e trajtuar në kërkesën e tij brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së saj.
- 9.3.** Anëtari kërkues ka të drejtë të kundërshtojë refuzimin e dhënies së informacionit, duke iu drejtar gjiqatës brenda 30 ditëve nga njoftimi për refuzim, ose brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, në rast se kërkesa e tij lihet pa përgjigje.
- 

10. DETYRIMET E ANËTARËVE

- 10.1.** Anëtarët janë të detyruar të përmbushin detyrimet e parashikuara nga ligji për shoqërítë e bashkëpunimit bujqësor si dhe ky statut dhe veçanërisht:
- 10.1.1.** të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme;
 - 10.1.2.** të zbatojnë marrëveshjet e miratuara nga organet e shoqërisë;
 - 10.1.3.** të marrin pjesë në veprimtari që përbëjnë objektin e shoqërisë, sipas përcaktimit të nenit 5 të këtij statuti, përveç rasteve kur asambleja e përgjithshme, për një shkak të justifikueshëm, e përjashton nga ky detyrim në masën që i takon dhe sipas rrethanave;
 - 10.1.4.** të ruajnë sekretin për ato çështje dhe të dhëna të shoqërisë, përhapja e të cilave mund të dëmtojë interesat e ligjshëm të saj;
 - 10.1.5.** të mos kryejnë veprimtari konkurruese me veprimtarinë e shoqërisë, përveçse kur kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të cilësisë së tij si anëtar i shoqërisë dhe objektit të saj dhe të mos bashkëpunojë me ata që zhvillojnë veprimtari konkurruese në të njëjtin sektor me shoqërinë, me përjashtim të rasteve kur autorizohen formalisht nga asambleja e përgjithshme;
 - 10.1.6.** të marrin pjesë në veprimtaritë e formimit dhe të kualifikimit;
 - 10.1.7.** të kryejnë derdhjen e kontributeve të tyre në kapitalin e shoqërisë në mënyrën e parashikuar;
 - 10.1.8.** të zbatojnë dhe respektojnë statutin, rregulloret e brendshme dhe çdo vendim të organeve të shoqërisë;
 - 10.1.9.** të njoftojnë menjëherë çdo ndryshim të adresës apo çdo fillim procedure likuidim ose falimentimi;
 - 10.1.10.** të përmbushin çdo detyrim tjetër që rrjedh nga ligji, statuti apo vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë.

11. LARGIMI I ANËTARIT

- 11.1.** Anëtari mund të largohet nga shoqëria nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:
- 11.1.1.** vullnetarisht, me anë të dorëheqjes;
 - 11.1.2.** i detyruar, me anë të përjashtimit në rastet e parashikuara në Ligjin për Shoqërítë e Bashkëpunimit Bujqësor dhe sipas procedurave të nenit 13 të statutit;
 - 11.1.3.** kur, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 28, transferon pjesën e zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë tek një individ ose person juridik, i cili ka marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme për të qenë anëtar;
- 

- 11.1.4.** në rast likuidimi, kur anëtarë eshtë person juridik;
- 11.1.5.** në rast falimentimi;
- 11.1.6.** në rast vdekjeje;
- 11.1.7.** në çdo rast tjetër, sipas përcaktiveve që mund të kryhen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 11.1.8.** Administratori shprehet me vendim të motivuar për largimin e anëtarit, për se cilin prej rasteve të parashikuara në nenin 11.1, dhe vendimin e marrë ia përcjell për miratim asamblesë së përgjithshme.
- 11.1.9.** Administratori eshtë i detyruar të shënojë në regjistrin e anëtarëve, që mbahet nga shoqëria, si dhe të regjistrojë në Qendrën Kombëtare të Biznesit largimin e anëtarit dhe çdo veprim, i cili ndryshon kapitalin e nënshkruar apo mënyrën e ndarjes së tij, si rrjedhojë e largimit të anëtarit.

12. LARGIMI VULLNETAR I ANËTARIT

- 12.1.** Largimi vullnetar i anëtarit lejohet, përvèç shkaqeve të parashikuara nga ligji, edhe për shkaqet e mëposhtme:
 - 12.1.1.** për shkak të mosmiratimit nga anëtarë i vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për ndryshimin e objektit të Shoqërisë;
 - 12.1.2.** në rastet kur anëtarë transferon vendbanimin e tij jashtë territorit ku ushtron veprimtarinë shoqëria, ose në rastet kur shoqëria e transferon veprimtarinë jashtë zonës në të cilën vepron anëtarë dhe rrjedhimisht vështirësitet apo bëhet e pamundur përbushja e marrëdhënieς anëtar - shoqëri;
 - 12.1.3.** për shkak të humbjes së kritereve të pranimit;
 - 12.1.4.** për shkak të pamundësisë së anëtarit që të marrë pjesë në përbushjen e objektit të shoqërisë.
- 12.2.** Largimi vullnetar i anëtarit nuk mund të jetë i pjesshëm. Anëtarë eshtë i detyruar të njoftojë shoqërinë me anë të një letre të porositur 60 ditë përpëra datës së largimit.
- 12.3.** Administratori verifikon nëse ekzistojnë kushtet për largimin vullnetar të anëtarit dhe në rast se çmon që nuk dëmtohen interesat e shoqërisë, shprehet me vendim të motivuar dhe ia dërgon vendimin asamblesë së përgjithshme për miratim. Anëtarë konsiderohet i larguar nga shoqëria pas miratimit nga asambleja e përgjithshme. Në rast se administratori çmon që nuk eksitojnë kushtet për largimin vullnetar të anëtarit apo largimi i anëtarit do të sillte dëme të pariparueshme për shoqërinë, vendos për mospranimin e kërkesës për largim vullnetar të anëtarit. Vendimi i administratorit për

The image shows five handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the members of the Assembly, placed at the bottom of the document to indicate their approval or signature.

pranimin e kérkesës apo pér refuzimin e saj duhet të merret brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kérkesës. Anëtari kérkues ka të drejtë të kundërshtojë vendimin e administratorit pér mospranimin e kérkesës, duke iu drejtar gjykatës brenda 30 ditëve nga njoftimi pér refuzimin e kérkesës.

13. PËRJASHTIMI I ANËTARIT

- 13.1.** Anëtari mund të përjashtohet nga shoqëria me vendim të asamblesë së përgjithshme, në rastin kur:
 - 13.1.1.** ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të tij ose ka vepruar në kundërshtim me interesat e shoqërisë;
 - 13.1.2.** nuk plotëson kriteret pér të qenë anëtar, sipas dispozitave të ligjit pér shoqëritet e bashkëpunimit buqësor dhe këtij statuti;
 - 13.1.3.** ka shkelur detyrimet e tij, të përcaktuara në nenet 10.1.2, 10.1.5, 10.1.7 dhe 10.1.10 të këtij statuti;
 - 13.1.4.** përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve ndërmjet anëtarit dhe shoqërisë;
- 13.2.** Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të përcaktojë si shkaqe të arsyeshme çdo veprim apo mosveprim, si dhe çdo gjendje të Anëtarit, sipas rastit, me qëllim mbrojtjen e interesave të shoqërisë.
- 13.3.** Vendimi pér përjashtimin e anëtarit merret nga Asambleja e Përgjithshme pas propozimit të administratorit ose anëtarëve të tjerë që përfaqësojnë jo më pak se 10% të kapitalit të regjistruar.
- 13.4.** Vendimi i largimit i njoftohet anëtarit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes me letër të porositur.
- 13.5.** Anëtari ka të drejtë të kundërshtojë vendimin e Asamblesë së Përgjithshme pér përjashtimin e tij, duke iu drejtar gjykatës brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit pér përjashtimin e tij.
- 13.6.** Shoqëria ka të drejtë të kérkojë kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga Anëtari i përjashtuar.

14. TË DREJTAT QË RRJEDHIN NGA LARGIMI VULLNETAR, PËRJASHTIMI APO VDEKJA E ANËTARIT

- 14.1.** Anëtarët e larguar vullnetarisht apo të përjashtuar nga shoqëria, si dhe trashëgimtarët e anëtarëve të vdekur kanë të drejtë t'u rimbursohen kontributet e derdhura në kapitalin e shoqërisë të përfaqësuara në kuotat e zotëruara.
- 14.2.** Rimbursimi bëhet në bazë të vlerës që kanë kuotat sipas bilancit kontabël deri në datën e largimit të anëtarit. Nga kjo vlerë, shoqëria ka të drejtë të mbajë çdo shumë që anëtar mund t'i detyrohet shoqërisë për shkak të shërbimeve të përfituar ose për shkak të dëmit të shkaktuar si pasojë e largimit.
- 14.3.** Rimbursimi duhet t'i bëhet anëtarit të larguar brenda 180 ditëve nga data e miratimit të bilancit nga Asambleja e Përgjithshme. Kjo e drejtë parashkruhet nëse rimbursimi nuk kryhet brenda 5 vjetësh nga data e largimit të anëtarit.
- 14.4.** Rimbursimi bëhet pa cënuar vlerën e kapitalit minimal, të përcaktuar në pikën 3 të nenit 27 të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.
- 14.5.** Vlera e kuotave për të cilat plotësohet afati i parashkrimit, destinohen në fondin e rezervës së detyrueshme.
- 14.6.** Anëtarët e larguar vullnetarisht si dhe ato të përjashtuar mund të ripranohen në Shoqëri. Në kërkesën për ripranim duhet të deklarohet shprehimi i kapërcimi i shkaqeve që quan në largimin vullnetar apo përjashtimin e anëtarit.

KAPITULLI IV

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

15. KOMPETENCAT

- 15.1.** Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqërisë.
- 15.2.** Asambleja e përgjithshme ka këto kompetenca:
- 15.2.1.** vendos drejtimin e politikave ekonomike të shoqërisë;
- 15.2.2.** analizon raportin e gjendjes financiare, përfshirë llogaritë vjetore, shpërndarjen e fitimeve, ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financier dhe çështje të tjera të veprimtarisë ekonomike, që çmohen të rëndësishme;
- 15.2.3.** emëron dhe shkarkon administratorin, ekspertin kontabël dhe likuiduesin, si dhe përcakton masën e shpërbimit të tyre;
- 15.2.4.** miraton zvogëlimin apo zmadhimin e kapitalit;

- 15.2.5.** miraton ndryshime të statutit;
- 15.2.6.** vendos për shpërndarjen apo mënyrën e përdorimit të fitimit të shoqërisë, sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe këtij statuti;
- 15.2.7.** vendos shkrirjen, ndarjen, transformimin apo shpërbërjen e shoqërisë;
- 15.2.8.** vendos për ndryshimet e strukturës ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë;
- 15.2.9.** vendos për pjesëmarrjen në forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik edhe me anë të pjesëmarrjes në kapital, aderimin në organizata me karakter përfaqësues dhe shkëputjen prej tyre;
- 15.2.10.** miraton pasqyrat financiare, raportet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e ekspertëve kontabël dhe të likuiduesve;
- 15.2.11.** miraton pranimin e anëtarëve të rindjeve pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë, si dhe largimin apo përjashtimin e tyre;
- 15.2.12.** ndarjen dhe anulimin e Kuotave;
- 15.2.13.** përfaqësimin në gjykatë të Shoqërisë dhe në procedura të tjera kundër Administratorëve apo anëtarëve;
- 15.2.14.** miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- 15.2.15.** çdo detyrë tjetër që çmohet e rëndësishme për mbrojtjen e interesave dhe nevojave të shoqërisë apo anëtarëve të saj.

- 15.3.** Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme, i marrë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor dhe këtij statuti, është i detyrueshëm për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

16. THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

- 16.1.** Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara me ligj, në këtë statut apo sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme thirret të paktën një herë në vit dhe brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vtitit finanziar.
- 16.2.** Asambleja e Përgjithshme thirret të vendosë për çështjet e përcaktuara nga Ligji për Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, Statuti si dhe për çdo çështje e cila nuk i është deleguar Administratorëve.
- 16.3.** Asambleja e Përgjithshme mblidhet në selinë e Shoqërisë.



The image shows four handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the members of the Assembly, placed at the bottom right of the document.

- 16.4.** Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori; ose nga çdonjëri prej Anëtarëve që përfaqësojnë të paktën 10% të kapitalit të shoqërisë.
- 16.5.** Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 16.6.** Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në çdo mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e të gjitha aseteve të Shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 16.7.** Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim, me postë të porositur ose elektronike, jo më vonë se 30 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Gjithsesi, në raste urgjente ky afat mund të reduktohet në 15 ditë. Njoftimi duhet të përbajë:
- 16.7.1.** emërtimin e shoqërisë; selinë e regjistruar; vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
- 16.7.2.** rendin e ditës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

17. E DREJTA E VOTËS

- 17.1.** Eshte sipas perqindejes se zoteruar. E drejta e votës gëzohet nga ata anëtarë të cilët janë regjistruar në Regjistrin e Anëtarëve të Shoqërisë nga të paktën 90 ditë nga data e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 17.2.** E drejta e votës ushtrohet nëpërmjet votimit të hapur, përveç rastit të zgjedhjes ose shkarkimit të administratorit të Shoqërisë. Votimi i hapur kryhet nëpërmjet sistemit të ngritisës së dorës ose nëpërmjet ngritisës dhe uljes së personit. Përveç sa më sipër, me votim të fshehtë mund të vendoset edhe për çështje të tjera, kur kjo kërkohet nga 1/3 e anëtarëve pjesëmarrës.

18. PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

- 18.1.** Anëtarët e shoqërisë mund përjashtohen nga e drejta e votës në rastin kur Asambleja e Përgjithshme është duke vendosur mbi:
- 18.1.1.** vlerësimin e veprimtarisë së këtij anëtari;
- 18.1.2.** shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- 18.1.3.** ngritjen e një padie kundër tij, nga Shoqëria;
- 18.1.4.** dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

19. PËRFAQËSIMI NË MBLEDHJE

- 19.1.** Një anëtar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nga një anëtar tjetër apo nga një person i tretë, në bazë të një prokure apo autorizimi të lëshuar nga anëtari, i cili përfaqësohet. Prokura apo autorizimi duhet të ketë përcaktuar shprehimisht që përfaqësuesi ka të drejtë të votojë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.
- 19.2.** Prokurat apo autorizimet përmenden në procesverbal dhe ruhen si pjesë e akteve të shoqërisë. Është i ndaluar leximi i prokurave apo autorizimeve në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- 19.3.** Prokura apo autorizimi nuk mund të lëshohet e paplotësuar, por duhet të përbajë të dhënrat e nevojshme për identifikimin e përfaqësuesit. Administratorët nuk mund të veprojnë si përfaqësues të anëtarëve në asamblenë e përgjithshme.
- 19.4.** Prokura mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 19.5.** Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë të tillë që, sipas gjykimit të anëtarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë, të ndryshëm nga ata të anëtarit të përfaqësuar.

20. KUORUMI DHE MARRJA E VENDIMEVE

- 20.1.** Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm anëtarët me të drejtë vote, të cilët përfaqësojnë më shumë se 30 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 20.2.** Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor ose në këtë statut, Asambleja e Përgjithshme miraton vendimet e saj për çështjet e përcaktuara ne nenin 15.2 të këtij statuti, me votat e anëtarëve, të cilët përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë, të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje.
- 20.3.** Pavarësisht sa është përcaktuar në pikat e mësipërme të këtij nen, kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështjet e mëposhtme (1) miratimin e zvogëlimit apo zmadhimit të kapitalit, (2) miratimin e ndryshimeve në statut, (3) shkrirjen, ndarjen, transformimin apo shpërbërjen e shoqërisë, si dhe (4) kur vendos për ndryshimet e strukturës ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm

anëtarët me të drejtë vote, të cilët përfaqësojnë më shumë se 50 për qind të kapitalit të shoqërisë.

- 20.4.** Asambleja e përgjithshme miraton vendimet e saj, në përputhje me përcaktimet e nenit 20.3, me votat e anëtarëve, të cilët përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit të shoqërisë, të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje.
- 20.5.** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në nenet 20.1 dhe 20.3 të këtij statuti, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

21. PROCESVERBALI I MBLEDHJES

- 21.1.** Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme dhe Sekretari.
- 21.2.** Kryetari i Asamblese se Pergjithshme zgjidhet Z. Amarildo Ismaili, atësia Hekuran, amësia Mynevere, posedues i Leternjoftimit ID nr. 033253584 dhe nr. personal J90415018P.
- 21.3.** Procesverbal duhet të përmbajë datën e vandin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të sekretarit, si dhe rezultatet e votimit. Prosesverbalit i bashkëlidhet lista e pjesëmarrësve, akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme, raportet dhe aktet e tjera të paraqitura në mbledhje si dhe prokurat apo autororizimet në rast se anëtarët përfaqësohen në mbledhje nga një anëtar tjetër apo nga një person i tretë.
- 21.4.** Prosesverbalit dhe dokumentet e bashkëlidhura duhet të ruhen për një periudhë 5-vjeçare dhe anëtarët mund të kërkojnë kopje të tyre.

KREU V

ADMINISTRATORI

22. ADMINISTRATORI

- 22.1.** Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator, të Drejtat dhe Detyrimet e të cilët janë të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, në Statutin e Shoqërisë si dhe në Aktin e Emërimit të tij.

- 22.2.** Administrator i Shoqërisë është:

Zoti **Florjan Ismaili**, atësia Hekuran, amësia Myneverë, shtetas Shqiptar, lindur në Trebël, Skrapar dhe banues në Divjakë, me adresë Mizë; Nd. 044; H. o; Ap. o; Divjakë; Mizë; 9022; Divjakë, lindur më 03/10/1988, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, posedues i Leternjoftimit ID nr. 036878539 dhe nr. personal I81009020I.

- 22.3.** Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit është për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 22.4.** Administratori zgjidhet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të zakonshme sipas përcaktimit të nenit 20.1 dhe 20.2 të këtij Statuti.
- 22.5.** Administratori vepron individualisht dhe si firmëtar i vetëm në lidhje me çdo çështje të Shoqërisë e cila i është caktuar shprehimisht ose në rast se nuk i është përcaktuar shprehimisht, çdo çështje që përfshihet në administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë.
- 22.6.** Administratorit, të cilin i ka mbaruar mandati i plotë i emërimit, kryen vetëm ato detyra, të cilat janë të nevojshme për përm bushjen e detyrimeve ligjore nga ana e shoqërisë, deri në emërimin e administratorit të ri.

23. TË DREJTAT DHE DETYRIMET

- 23.1.** Të gjitha vendimet e marra nga administratori do të quhen të vlefshme kur: janë firmosura nga ai dhe janë në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 23.2.** Administratori ka këto kompetenca:
- 23.2.1.** kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, duke zbatuar politikat e përcaktuara nga asambleja e përgjithshme;
- 23.2.2.** përfaqëson shoqërinë;
- 23.2.3.** thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, në rastet e përcaktuara nga ky statut apo nga legjislacioni në fuqi.
- 23.2.4.** kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve, të regjistrave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- 23.2.5.** përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet këto dokumente asamblesë së përgjithshme për miratim;
- 23.2.6.** krijon një sistem informimi dhe vlerësimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

- 23.2.7.** kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, kur parashikohet nga dispozitat ligjore ose është në interesin më të lartë të shoqërisë;
- 23.2.8.** i raporton asamblesë së përgjithshme për zbatimin e orientimeve dhe për realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- 23.2.9.** kryerjen e çdo detyre tjetër të caktuara në ligj, nga Asambleja e Përgjithshme si dhe nga Akti i Emëritit të tij.
- 23.3.** Administratori mbikëqyr dhe siguron që zyrtarët, agjentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë.

24. DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

- 24.1.** Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), administratori detyrohet:
- 24.1.1.** të kryej detyrat e tij të përcaktuara në ligj, në këtë Statut ose në Aktin e Emëritit të tij në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë realizimit të suksesshëm të objektit të shoqërisë dhe ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- 24.1.2.** të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita dhe duke konsideruar si të rëndësishëm interesin e shoqërisë dhe të anëtarëve të saj;
- 24.1.3.** të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- 24.1.4.** të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- 24.1.5.** të ushtroj detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.



KAPITULLI VI
REGJIMI EKONOMIK

25. KAPITALI I REGJISTRUAR


- 25.1.** Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është në total **100000 Leke** (te reja), **i** Kapitali ndahet në **7 kuota**, plotësisht të nënshkruara dhe të shlyera.
- 25.2.** Kapitali i regjistruar i shoqërisë zotërohet nga Anëtarët si më poshtë vijon:

<i>Anëtari</i>	<i>Kuota</i>	<i>Përqindja e zotëruar</i>	<i>Kontributi ne Leke</i>
1. Florjan Ismaili	1	30	30000
2. Amarildo Ismaili	1	30	30000
3. Semi Ismaili	1	30	30000
4. Xhezilajda Ismaili	1	3	3000
5. Enkeleda Ismaili	1	3	3000
6. Mynevere Ismaili	1	2	2000
7. Keze Kaja	1	2	2000
Totali	7	100	100000

26. ZVOGËLIMI OSE ZMADHIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR

- 26.1.** Kapitali mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të ligjit të shoqërite të bashkëpunimit bujqësor.
- 26.2.** Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e fitimit. Kontributet në natyrë duhet të shprehen në vlerë ekonomike, në bazë të një raporti vlerësimi, të bërë nga një ekspert. Nëse nuk mund të arrihet në mirëkuptim për vlerësimin, secili prej anëtarëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me të dhënrat e tjera, të kérkuara për regjistrimin e zmadhimit të kapitalit.
- 26.3.** Zmadhimi i kapitalit kryhet nëpërmjet emetimit të kuotave të reja, apo nëpërmjet rritjes së vlerës së tyre. Kuotat do të jenë të nënshkruara dhe vlera e tyre do të jetë e shlyer plotësisht.
- 26.4.** Ndryshimi i kapitalit nuk mund të arrijë deri aty sa të jetë më i vogël se kapitali minimal i përcaktuar në pikën 3 të nenit 27 të Ligjit të Shoqërite të Bashkëpunimit Bujqësor.
- 26.5.** Shoqëria nuk mund të blejë asnje kuotë të saj. Megjithatë me qëllim zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogëlimin e kapitalit, Anëtarët mund të autorizojnë Administratorin të blejnë kuotat përkatëse dhe t'i anulojnë ato.

27. ANULIMI I KUOTAVE

- 27.1.** Shoqëria ka të drejtë të anulojë kuotat e kapitalit të saj dhe t'i likuidojë ato sipas vlerës së tyre kontabël.
- 27.2.** Shoqëria mund t'i anulojë kuotat e saj për shkak të:
- 27.2.1.** Detyrimeve të anëtarëve ndaj palëve të treta;
 - 27.2.2.** Shkrirjen, likuidimin dhe/ose falimentimin e anëtarit;
 - 27.2.3.** Vdekjen e anëtarit dhe problemeve me trashëgiminë;
 - 27.2.4.** Largimin vullnetar të anëtarit, në përputhje me nenin 12 të këtij Statuti;
 - 27.2.5.** Përjashtimin e anëtarit në përputhje me nenin 13 të këtij Statuti;
 - 27.2.6.** Zvogëlimin e Kapitalit;
 - 27.2.7.** Transferimin e Kuotave të parashikuar në Nenin 28 të këtij Statuti.
- 


28. TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

- 28.1.** Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të transferohen, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 7 dhe 8 të këtij statuti, nëpërmjet:
- 28.1.1.** nënshkrimit të kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - 28.1.2.** shitblerjes;
 - 28.1.3.** trashëgimisë, kur të interesuarit kërkojnë të jenë anëtarë. Transferimi i pjesës tek të interesuarit, të cilët gjëzojnë cilësinë e trashëgimtarit dhe që kërkojnë të jenë anëtarë, bëhet brenda gjashtë muajve nga vdekja e anëtarit. Në rastet kur nuk përmbushet kushti i sipërpërmendur, ata kanë të drejtë të kërkojnë likuidimin e pjesës përkatëse;
 - 28.1.4.** dhurimit;
 - 28.1.5.** në çdo mënyrë tjeter të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- 28.2.** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

29. FONDI I REZERVËS SË DETYRUESHME

- 29.1.** Shoqëria krijon fondin e rezervës së detyrueshme, i cili destinohet për konsolidimin dhe garancinë e kapitalit të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor e të aftësisë paguese të saj dhe është i pandashëm ndërmjet anëtarëve dhe i patransferueshëm, përvçe rasteve të parashikuara në nenin 56 të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.
- 29.2.** Fondi i rezervës së detyrueshme krijohet nga derdhja në këtë fond e jo më pak se 15 për qind të fitimit neto, të realizuar gjatë vitit finanziar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura, në masën derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me kapitalin e shoqërisë, sipas nenit 25 të këtij statuti, apo çdo rritje të mëvonshme të tij.

30. FONDI I PËRBALLIMIT TË RISKUT

- 30.1.** Shoqëria krijon fondin e përballimit të riskut, që shërben për përballimin nga shoqëria të rreziqeve apo dëmeve të çfarëdolloj natyre, me të cilat mund të përballet veprimtaria e shoqërisë, përfshirë këtu edhe fenomenet natyrore apo ato dëme dhe risqe, të cilat janë të lidhura me vetë llojin e veprimtarisë ose të produktit.
- 30.2.** Shoqëria depoziton në fondin e përballimit të riskut 10 për qind e fitimit neto, të realizuar gjatë vitit finanziar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura. Ky
- 

fond është i pandashëm ndërmjet anëtarëve dhe i patransferueshëm, përveç rasteve të parashikuara në nenin 56 të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.

31. DOKUMENTACIONI DHE KONTABILITETI

- 31.1.** Shoqëria mban të dhënat e veprimtarisë së saj në:

 - 31.1.1.** regjistrin e anëtarëve;
 - 31.1.2.** regjistrin e vendimeve të organeve të saj;
 - 31.1.3.** regjistrat për veprime financiare dhe kontabël

- 31.2.** Shoqëria mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike, në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar.
- 31.3.** Administratori përgatit raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore, në përputhje me legjislacionin kontabël, të cilat i paraqiten asamblesë së përgjithshme pëmiratim.
- 31.4.** Mbajtja e regjistrave të shoqërisë është nën përgjegjësinë e administratorit. Mënyrat dhe afatet e ruajtjes së tyre përcaktohen në rregulloret e brendshme të Shoqërisë.

32. MBAJTJA E LLOGARIVE

- 32.1.** Shoqëria do të mbajë llogaritë në lek dhe në monedhë të huaj.

33. LLOGARITJA DHE SHPËRNDARJA E FITIMIT

- 33.1.** Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin, dhe me ligjet e zbatueshme.
- 33.2.** Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Anëtarët vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:

 - 33.2.1.** Asetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - 33.2.2.** Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

The image shows two handwritten signatures in blue ink, placed over the typed names of the signatories. The signatures are fluid and unique to each individual.

KREU VII

NDRYSHIMI I FORMËS LIGJORE DHE PRISHJA E SHOQËRISË

34. PRISHJA E SHOQERISE SE BASHKEPUNIMIT BUJQESOR

- 34.1.** Shoqëria shkrihet dhe hyn në proces likuidimi për shkaqet e mëposhtme:
- 34.2.** vullneti i anëtarëve, i manifestuar nëpërmjet vendimit të asamblesë së përgjithshme;
- 34.3.** përbushja e plotë e objektit të shoqërisë ose pamundësia për ta përbushur atë;
- 34.4.** zvogëlimi i numrit të anëtarëve nën minimumin ligjor të nevojshëm, për të krijuar një shoqëri, sipas dispozitave të ligjit, nëse numri i nevojshëm i anëtarëve nuk rivendoset brenda një periudhe prej 6 muajsh;
- 34.5.** bllokimi i veprimtarisë vendimmarrëse të ndonjërit prej organeve të shoqërisë ose mosushtimi i veprimtarisë së shoqërisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;
- 34.6.** reduktimi i kapitalit të shoqërisë nën minimumin e përcaktuar në ligj, nëse nuk rivendoset brenda një periudhe gjashtëmuore;
- 34.7.** nisja e procedurave të falimentimit;
- 34.8.** mos ushtrimi i veprimtarisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare dhe mosnjoftimi i pezullimit të veprimtarisë, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”
- 34.9.** nëse shoqëria rezulton me humbje për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare
- 34.10.** me vendim të gjykatës;
- 34.11.** për çdo arsyet tjetër, të përcaktuar në ligj.

35. LIKUIDIMI

- 35.1.** Përveç rasteve kur kundrejt shoqërisë është hapur një procedurë falimentimi të personit juridik, sipas dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, verifikimi i një prej shkaqeve të përmendura në nenin 45 të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, ka si pasojë hapjen e fazës së likuidimit të shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese.
- 35.2.** Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30

ditëve pas vendimit të prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

- 35.3.** Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, nëse paraqet arsyë të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër.
- 35.4.** Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit të emëruar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij nen, nëse paraqet arsyë të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.
- 35.5.** Likuiduesi emërohet nga gjykata në rastet kur shoqëria prishet me vendim të gjykatës.

KREU VIII

TË NDRYSHME

36. DISPOZITAT E FUNDIT

- 36.1.** Në qoftë se ndonjë nga dispozitat e këtij statuti ose ndonjë dispozitë që bëhet pjesë e statutit në të ardhmen është e pavlefshme ose e pazbatueshme, pjesërisht apo plotësisht, apo vlefshmëria apo zbatueshmëria e saj humbet në të ardhmen, apo statuti përmban mangësi, nuk do të ndikohet vlefshmëria e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme apo e pazbatueshme - ose me qëllim rregullimin e mangësive - do të zëvëndësohet nga një dispozitë tjeter, sipas vendimit të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me parashikimet ligjore, e cila duhet të reflektojë në mënyrën më të përafërt vullnetin fillestar të anëtarëve.
- 36.2.** Çdo çështje tjeter, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga legjislativi përkatës shqiptar.
- 36.3.** Për aq sa është e lejuar nga ligji, kompetencën territoriale për mosmarrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe anëtarëve e ka Gjykata e Rethit Gjyqësor Tirane.

ANETARET THEMELUES

1. FLORJAN HEKURAN ISMAILI
2. AMARILDO HEKURAN ISMAILI
3. XHEZILAJDA ASIM ISMAILI
4. SEMI HEKURAN ISMAILI
5. ENKELEDA FATOS ISMAILI
6. MYNEVERE SYBI ISMAILI
7. KEZE JONUZ KAJA

Florjan Ismaili
Amorilde Ismaili
Xhezilajda Ismaili
Semi Ismaili
Enkeleda Ismaili
Mynevere Ismaili
Keze Moja